

## VENDIM

Nr.867, date 17.12.2004

PER NJE NDRYSHIM NE VENDIMIN NR.238, DATE 13.4.2001 TE KESHILLIT TE MINISTRAVE "PER KRITERET E DHENIES SE LEJES PER LOJERAT E FATIT, KAZINOTE DHE HIPODROMET", TE NDRYSHUAR

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës dhe te pikës 2 te nenit 15 te ligjit nr. 8701, date 1.12.2002 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", me propozimin e Ministrit te Financave, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

Pika 7 e kapitullit II "Kriteret e dhënies se lejes për kazinotë", te vendimit nr.238, date 13.4.2001 te Këshillit te Ministrave, te ndryshuar, ndryshohet si me poshtë vijon:

"7. Përzgjedhja e subjekteve ne te dyja fazat behet nga komisioni i vlerësimit te kërkesave, i cili ka ne përbërje:

- a) drejtorin e Drejtorisë se Legjislacionit ne Ministrinë e Financave kryetar;
- b) drejtorin e Drejtorisë për Zhvillimin e Zonave Turistike ne Ministrinë e Rregullimit te Territorit dhe te Turizmit anëtar;
- c) një përfaqësues nga Drejtoria e Krimit te Organizuar ne Ministrinë e Rendit Publik anëtar;
- ç) një përfaqësues nga Ministria e Financave anëtar;
- d) një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë anëtar;
- dh) një përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë anëtar."

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit te Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI

Fatos Nano